



Prishtinë, 23 dhjetor 2014  
Kodi i ZRRE-së: V\_677\_2014

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Duke u Bazuar në:**

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.03/L-185;
- Dispozitat e Nenit 19 të Ligjit për Ngrohjen Qendrore Nr. 03/L-116; dhe
- Kërkesën e Ngrohtores së Qytetit (NQ) Termokos SH.A të datës 16 dhjetor 2014 për aprovimin e Marrëveshjes;

**në seancën e mbajtur me datë 23 dhjetor 2014, nxori këtë:**

## **VENDIM**

- I. APROVOHET** Marrëveshja për furnizim me ngrohje e lidhur me datën 15 dhjetor 2014 në mes të KEK-Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. dhe NQ Termokos sh.a.


### **Arsyetim**


- Me datën 16 dhjetor 2014, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar shkresën nga Ngrohitorja e Qytetit (NQ) Termokos SH. A, me anë të së cilës kërkohet që të aprovohet Marrëveshja për furnizim me ngrohje KEK sh.a. – NQ Termokos sh.a. e nënshkruar nga të dy palët me datë 15 dhjetor 2014, e cila ishte dorëzuar bashkangjitur me shkresën.
  - Marrëveshja në fjalë përmban të gjithë komponentët e kërkuar me nenin 19 të Ligjit për Ngrohjen Qendrore Nr. 03/L-116.
  - Duke marr parasysh dispozitat ligjore të theksuara në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e shkresës së NQ Termokos sh.a. të datës 16 dhjetor 2014, si dhe Marrëveshjes së bashkangjitur, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
  - III.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.




**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**

  
Enver Halimi, Kryesues

  
Merita Kostari, Anëtare

  
Krenar Bujupi, Anëtar